

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7991
E enjte, 13 shkurt 2025
Çmimi 0.50 €

Rutte: NATO do të punojë me këdo që do ta udhëheqë Kosovën | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) THOTË SE REZULTATET E ZGJEDHJEVE DO TË JENË TË SAKTA PAVARËSISHT PREJ VONESAVE DHE DYSHIMEVE

NË 14 KOMUNA TË TJERA FILLON NUMËRIMI I VOTAVE TË KANDIDATËVE DHE VERIFIKIMI I REZULTATEVE TË SUBJEKTEVE POLITIKE.

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ditën e mërkurë ka filluar procesi i numërimit të votave


të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike në 14 komuna të tjera. Në ndërkohë

zyrtarët e saj kanë siguruar se rezultatet e zgjedhjeve do të jenë të sakta pavarësisht prej vonesave dhe dyshimeve

KRYEBASHKIAKU I TIRANËS PARA GJYKATËS SI I DYSHUAR PËR KORRUPSION | F.3




REZULTATI I ZGJEDHJEVE S'E PËRJASHTON MUNDËSINË E KRIZËS INSTITUCIONALE | F.7




OPINION

ZGJEDHJET PRODHUAN KRIZË POLITIKE | F.6

Shkruan:
Astrit GASHI



AKTUALE



ZELENSKY: UKRAINA DO TA SHKËMBENTE TOKËN E KAPUR NË KURSK ME TERRITORIN E PUSHTUAR NGA RUSIA | F.2

CILI ËSHTË QËNDRIMI I PARTIVE JOSERBE PËR QEVERINË E ARDHSHME TË KOSOVËS? | F.5

EKONOMI



NDËRMARRËSIT E KOSOVËS PËRFITOJNË NGA PUNËTORIA PËR EDUKIM FINANCIAR | F.8

MË 19 SHKURT MBAHET ANKANDI I DYTË I LETRAVE ME VLERË PËR VITIN 2025 | F.8

SPORT

KUALIFIKOHEN LLAPI, MALISHEVA, VËLLAZNIMI DHE DRITA | F.8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Ukraina do ta shkëmbente tokën e kapur në Kursk me territorin e pushtuar nga Rusia

KIEV, 12 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se synon ta ofrojë tokën ruse që forcat ukrainase e kanë kapur në rajonin Kursk të Ruisë në këmbim të territorit të pushtuar nga Rusia, nëse Ukraina dhe Rusia ulen për të biseduar për përfundimin e luftës. "Ne do ta shkëmbejmë një territor për një territor tjetër", tha Zelensky në një intervistë për gazetën britanike "Guardian".

Megjithatë, ai shtoi se nuk e di se cilin territor do ta kërkonte Kievi nga Moska në këmbim të pjesës së rajonit të Kurskut. "Nuk e di, do ta shohim. Por, të gjitha territoret tona janë të rëndësishme, nuk ka prioritet këtu", tha Zelensky në intervistën e publikuar më 11 shkurt.

Në të kaluarën Zelensky kishte hedhur poshtë mundësinë e dorëzimit të territorit të pushtuar nga Rusia, e cila e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës në vitin 2022.

Zelensky, i cili do të takohet me nënpresidentin amerikan JD Vance dhe zyrtarë të tjerë amerikanë më 14 shkurt në Konferencën e Sigurisë në Muni, tha se është i gatshëm për bisedime serioze.

Intervista u publikua vetëm disa orë para një tjetër sulmi vdekjeprurës me raketa ruse në Kiev.

Kryetari i bashkisë së Kievit, Vitaly Klitschko, tha se raketat goditën në orët e para të 12 shkurtit, duke e vrarë të paktën një person dhe duke plagosur tre të tjerë. "Rusia kreu një sulm me raketa në Kiev dhe rajonin e Kievit", tha Andriy Yermak, kreu i zyrës së Zelenskyt. "Kështu dëshiron ta përfundojë luftën [presidenti rus Vladimir Putin]", shtoi ai në Telegram.

Shërbimet e urgjencës u thirrën në të paktën katër qarqe të kryeqytetit ukrainas, dhe administrata ushtarake tha se shpërthyen zjarre në disa ndërtesa, përfshirë në ndërtesa banimi.

Sulmet në rajonin e Sumit më 11 shkurt vranë të paktën dy civilë, plagosën dy të tjerë dhe shkaktuan dëme të mëdha në ndërtesa banimi dhe prona të tjera, tha shërbimi për shtyp i administratës ushtarake rajonale.

Presidenti amerikan, Donald Trump, i cili ka qenë skeptik për vazhdimin e mbështetjes amerikane për Kievin, po shtyn për një marrëveshje për



përfundimin e luftës dhe ka rritur përpjekjet diplomatike ditë e fundit.

I dërguari i tij për Rusinë dhe Ukrainën, Keith Kellogg, do të marrë pjesë gjithashtu në Konferencën e Sigurisë në Muni dhe më pas do të udhëtojë për në Ukrainë.

Trump është ankuar për koston e ndihmave që Shtetet e Bashkuara kanë derdhur në Ukrainë dhe ka thënë se SHBA-ja do të kërkojë diçka në këmbim. "Ata mund të bëjnë marrëveshje, mund të mos

bëjnë marrëveshje, mund të bëhet ruse një ditë, apo mund të mos bëhet ruse një ditë. Por, ne do t'i kemi të gjitha këto para atje dhe them se do t'i marrim ato para", tha Trumpi më 10 shkurt në një intervistë për "Fox News".

Zelensky i tha gazetës "Guardian" se vitin e kaluar i propozoi Trumpit idenë që Shtetet e Bashkuara do të kishin qasje primare në mineralet e rralla të Ukrainës si pjesë e një marrëveshjeje për t'i dhënë fund luftës.

Ai tha se Ukraina i ka rezervat më të mëdha të uraniumit dhe titanit në Evropë dhe ia bëri me dije Trumpit se nuk do të ishte në interesin e Shteteve të Bashkuara që këto rezerva të binin në duart e Ruisë dhe mbase të ndaheshin me Korenë e Veriut, Kinën ose Iranin.

Së fundmi, Trump ka përmendur mineralet e rralla si pjesë të një marrëveshjeje për luftën në Ukrainë dhe ka thënë se sekretari i Thearit i ShBA-së, Scott Bessent, do të udhëtojë në Ukrainë për të diskutuar për mineralet e rralla.

Zelensky tha se synon t'u paraqesë zyrtarëve të administratës Trump "një plan më të hollësishëm" për mineralet e rralla dhe mundësitë e tjera për kompanitë amerikane, si pjesë e rindërtimit të Ukrainës pas luftës.

Ai theksoi se mbështetja ushtarake amerikane mbetet thelbësore për sigurinë e Ukrainës. "Garancitë e sigurisë pa Amerikën nuk janë garanci të mirëfillta të sigurisë", tha ai, duke bërë një tjetër thirrje për më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore, Patriot, të prodhuara nga SHBA-ja.

FBI-ja thotë se ka gjetur 2 400 dosje të reja që lidhen me vrasjen e ish-presidentit Kennedy



WASHINGTON, 12 SHKURT - Byroja Federale e Hetimeve ka zbuluar 2400 dosje të reja që lidhen me vrasjen e ish-presidentit John F. Kennedy, ndërsa agjencitë federale punojnë për të përmbushur urdhrin ekzekutiv të presidentit Donald Trump muajin e kaluar për të publikuar mijëra të dhëna.

FBI-ja tha se po punon për transferimin e të dhënave tek Administrata Kombëtare e Arkivave dhe Regjistrimeve për t'u përfshirë në procesin e deklasifikimit.

Në vitin 1992, Kongresi kishte urdhëruar që të gjitha dosjet e mbetura sekrete në lidhje me hetimin për vrasjen e ish-presidentit Kennedy duhet të hapeshin plotësisht për publikun përmes Arkivave Kombëtare pas 25 vjetësh, më 26 tetor 2017, me përjashtim të atyre që presidenti autorizoi të mbaheshin ende sekret.

Ndërsa shumica e koleksionit, ku përfshihen mbi 5 milionë faqe dokumentesh, janë bërë publike, hulumtuesit vlerësojnë se rreth 3 000 dosje nuk janë publikuar, pjesërisht

apo në tërësi.

FBI-ja nuk tha se çfarë të dhënash përmbajnë dosjet e zbuluara. Në vitin 2020, Byroja Federale e Hetimeve hapi një qendër për dokumentacionin, duke filluar përpjekjet shumëvjeçare për grumbullimin dhe inventarin elektronik të çështjeve të mbyllura nga zyrat e saj në të gjithë vendin.

Agjencia tha se një inventar më gjithëpërfshirës i të dhënave dhe teknologjia e përparuar mundësuan gjetjen e dokumenteve në fjalë.

Netanyahu paralajmëron rifillimin e luftës në Gazë nëse pengjet nuk lirohen të shtunën

JERUSALEM, 12 SHKURT - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka kërcënuar të martën se vendi i tij do të tërhiqet nga marrëveshja për armëpushim në Rripin e Gazës dhe do ta rifillojë luftën kundër Hamasit nëse grupi i shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe BE-ja nuk e liron grupin e radhës të pengjeve të shtunën.

Hamasit tha të hënën dhe e përsëriti të martën se synon ta shtyjë lirinë e tri pengjeve të tjera, duke e akuzuar Izraelin se nuk i ka plotësuar kushtet e armëpushimit. Sipas Hamasit, Izraeli nuk ka lejuar futjen e më shumë tendave dhe ndihmave të tjera humanitare në Gazë.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e

ka inkurajuar Izraelin të kërkojë lirinë e edhe më shumë pengjeve të shtunën. Megjithatë, nuk është e qartë nëse kërcënimi i Netanyahu i referohet liritë të të gjitha pengjeve të mbetur në Gazë, apo vetëm të tri pengjeve të planifikuara për t'u liruara të shtunën.

Më herët të martën, një zyrtar izraelit tha se

Netanyahu ka urdhëruar ushtrinë të dërgojë më shumë trupa brenda dhe rreth Rripit të Gazës.

Netanyahu gjithashtu urdhëroi zyrtarët "të përgatiten për çdo skenar, nëse Hamas nuk i liron pengjet tona këtë të shtunë", sipas zyrtarit, i cili foli në kushte anonimiteti, raporton Associated Press.



Rutte: NATO do të punojë me këdo që do ta udhëheqë Kosovën

PRISHTINË, 12 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë se pret që pas zgjedhjeve në Kosovë, të ketë një qeveri stabile dhe se NATO-ja do të punojë me këdo që do ta udhëheqë vendin. Ai e ka thënë këtë në një konferencë me gazetarë, në të cilën ka folur për takimin e ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare, që zhvillohet të enjten në selinë e kësaj aleance në Bruksel. "Ky ka qenë një proces demokratik. Ajo që ne kuptojmë është se i kemi rezultatet fillestare, por ende po vazhdon numërimi i votave dhe do t'i kemi edhe rezultatet finale. Dhe, bazuar në rezultatet deri tash duket se do të ketë një qeveri të koalicionit", ka thënë Rutte. "Natyrisht, ne sigurojmë që do të punojmë me këdo që do të udhëheqë me vendin. Dhe natyrisht u dëshirojmë të gjithë politikanëve gjithë të mirat në drejtimin e hapësirës politike dhe që të sigurojnë që të ketë një qeveri stabile sa më parë që të jetë e mundur", ka thënë Rutte. Të dielën, më 9 shkurt, në

Kosovë u mbajtën zgjedhjet parlamentare.

Në bazë të 99 për qind të votave të numëruara, Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin Kurti mori më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, përkatësisht 47 nga 120 vendet parlamentare - megjithatë, jo mjaftueshëm për ta formuar qeverinë e vetme.

Sipas rezultateve preliminare, Partia Demokratike e Kosovës pritet t'i ketë 25 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës 20 dhe koalicioni i mbledhur rreth Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës 8 deputetë. Këto shifra mund të ndryshojnë pas numërimit të votave me kusht dhe atyre të diasporës.

Pas shpalljes së fitores në zgjedhjet e së dielës, Kurti tha se Vetëvendosja do ta formojë në mënyrë të pavarur qeverinë.

Analistët në Kosovë vlerësojnë se rezultatet aktuale preliminare të subjekteve politike në zgjedhjet e 9 shkurtit krijojnë paqartësi lidhur me konfiguracionin e saktë të



Kuvendit dhe qeverisë së ardhshme të vendit.

Përfaqësues politikë të komuniteteve pakicë joserbe në Kosovë, të cilët, sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë hyrë në Kuvendin e Kosovës, do të mbështesnin - parimisht - cilindo mandatar për

formimin e qeverisë së re, pavarësisht nëse do të vinte nga partia aktuale në pushtet, Vetëvendosje, apo nga partitë opozitare.

Zgjedhjet e 9 shkurtit ishin zgjedhjet e para të rregullta që Kosova ka mbajtur që nga shpallja e pavarësisë. Vëzhguesit thanë se zgjedhjet ishin të qeta, me disa

parregullsi, por pa incidente të mëdha.

Dalja ishte 40.59 për qind e mbi 1.9 milion votuesve me të drejtë vote në Kosovë. Paraprakisht, për këto zgjedhje ka votuar edhe diaspora, nëpërmjet postës, por edhe fizikisht në disa përfaqësi diplomatike të Kosovës në botë.

Kryebashkiaku i Tiranës para gjykatës si i dyshuar për korrupsion

TIRANË, 12 SHKURT - Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, dhe bashkëshortja e tij, janë paraqitur mëngjesin e së mërkurës në Gjykatën e Posaçme, në një seancë ku gjykatësi pritet të vendosë për masat e sigurisë kundër tyre në një rast të dyshuar korrupsionit dhe ryshfeti. Veliaj, një figurë e rëndësishme e partisë në pushtet në Shqipëri, Partia Socialiste, u arrestua të hënën dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) ka kërkuar që ai të mbahet në paraburgim. Ai akuzohet për korrupsion që përfshin të paktën 1.1 milion euro fonde publike, duke u dhënë para publike bizneseve të cilat në këmbim i jepnin familjes së tij fitime të paligjshme. Ndërkohë, prokurorët kërkuar që bashkëshortja e Veliajt, Ajola Xoxa, të mbahet në arrest shtëpiak si e dyshuar për korrupsion pasiv, shpëlarje parash dhe për mosdeklarim të të ardhurave. Seanca u ndërpre pas gjysmë ore dhe do të rinisë në orën 13:30, pasi avokatët kanë kërkuar kohë të njihen me dosjen dhe më pas t'i shprehin pretendimet e tyre kundër SPAK-ut. Derisa Veliaj doli para gjykatës, kryeministri dhe kreu i Partisë Socialiste në



pushtet, Edi Rama, tha para deputetëve se "nuk ka prova" ndaj Veliajt dhe e cilësoi dosjen e prokurorisë si "një roman prej 400 faqesh, me shumë personazhe, por pa fakte".

Ai theksoi se qëndrimi i qeverisë dhe partisë që drejton për ta mbështetur drejtësinë dhe luftën ndaj korrupsionit nuk ndryshon, por tha se "mungon një palë konstruktive që të jetë garantuese e pavarësisë së drejtësisë".

Në këtë rast po hetohet edhe deputetja socialiste Klotilda

Bushka, e dyshuar për "veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës". Bushka tha se nuk është thirrur asnjëherë dhe nuk i është dhënë mundësia të sqarohet. Ajo pranoi se ka qenë pjesë e disa aktiviteteve të shoqërisë civile, por tha se ka qenë aty si "bashkëpunëtoresh dhe mike e organizatorëve".

Më vonë, përmes një reagimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor u bëri thirrje të gjithë aktorëve që ta shmangin trysinë në formën e deklaratave, citimeve apo aludimeve që cenonjë

gjyqtarët për shkak të ushtrimit të funksionit. "KLGj mban qëndrimin se çdo përpjekje për ta cenuar pavarësinë e gjyqësorit, nëpërmjet trysnisë apo presionit të çfarëdo lloji, përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj pavarësisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit", thuhet në reagimin e Këshillit.

Veliaj - në mandatin e tij të tretë si kryetar bashkie - dyshohet se ka krijuar një skemë korruptive mes disa kompanive në pronësi të bashkëshortes së tij dhe

gjashtë biznesmenëve të lidhur me të.

Ai i ka mohuar të gjitha akuzat.

SPKA tha se hetimet kanë gjetur se Veliaj dhe bashkëshortja e tij kanë "ideuar, krijuar dhe vënë në funksionim një mekanizëm që ka synuar dhe ka bërë të mundur, në praktikë, marrjen e përfitimeve të parregullta, të cilat burojnë nga fondet publike që administrohen nga Bashkia Tiranë, përmes titullarit të saj, me qëllim pasurimin personal të këtij të fundit dhe familjes së tij, përmes veprimeve të kamufluara dhe të kundërligjshme".

Hetimet kanë treguar se bashkëshortja e Veliajt, vetë ose përmes personave të afërt me të, ka bërë blerje online në vlerën 86.721.175 lekë (873.878 euro), kryesisht veshje dhe bizhuteri. Këto shpenzime nuk rezultojnë të jenë deklaruar, siç e parashikon ligji.

Gjykata ka urdhëruar edhe sekuestrimin e disa llogari bankare të Ajola Xoxës dhe shoqërive të lidhura me të, që kapin vlerën e 869.149 eurove. Ndërsa në zyrat e një prej shoqërive të administruara prej saj janë gjetur në një kasafortë dhe janë sekuestruar 95 350 euro, 14 900 dollarë dhe 665 000 lekë (6 700 euro).

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) THOTË SE REZULTATET E ZGJEDHJEVE DO TË JENË TË SAKTA PAVARËSISHT PREJ VONESAVE DHE DYSHIMEVE

Në 14 komuna të tjera fillon numërimi i votave të kandidatëve dhe verifikimi i rezultateve të subjekteve politike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ditën e mërkurë ka filluar procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike në 14 komuna të tjera. Në ndërkohë zyrtarët e saj kanë siguruar se rezultatet e zgjedhjeve do të jenë të sakta pavarësisht prej vonesave dhe dyshimeve



EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ditën e mërkurë ka filluar procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike në 14 komuna të tjera.

Nga Qendra Komunale e Numërimit (QKN) në Prishtinë, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar se këto 14 komuna i janë bashkuar procesit të numërimit dhe verifikimit që filloi të martën në qendrat e tjera, si: Prishtinë, Lipjan, Obiliq dhe Partesh. “Gjatë ditës së sotme, e mërkurë, në orën 16:00 është planifikuar të fillojë procesi i numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit në Komunitet: Deçan, Gjakovë, Glogoc, Gjiçan, Fushë-Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Skenderaj, Shtërpçë, Viti, Ranillug, Klokot dhe Mitrovicë e Veriut, kurse në orën 13:00ka filluar numërimi në Hanin e Elezit”, njoftoi Elezi.

Ai ka sqaruar më tej se krahas numërimit të votave të kandidatëve, do të bëhet edhe verifikimi i votave të subjekteve politike nga formularët të cilët janë plotësuar në vendvotime. “Në Qendrat Komunale të Numërimit, përveç procesit të numërimit të votave të kandidatëve për deputetë, do të bëhet verifikimi i votave të subjekteve politike nga formularët të cilët janë plotësuar në vendvotime pas numërimit të votave për subjektet politike. Ky verifikim është paraparë me aktet nënligjore që janë miratuar nga KQZ qysh para shpalljes së datës së zgjedhjeve dhe sigurisht se kjo do t'i heqë të gjitha dilemat që janë krijuar gjatë problemeve në publikimin e rezultateve preliminare për subjektet politike”, tha Elezi.

Elezi ka thënë se pas përfundimit të votimit në vendvotime si dhe pas përfundimit të votimit jashtë Kosovës në përfaqësi diplomatike dhe përmes postës, i gjithë angazhimi i institucionit është i

përqendruar në shpalljen e rezultateve përfundimtare dhe subjektet politike dhe kandidatët për deputetë. “Deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare, KQZ duhet t'i numërojë votat e kandidatëve për deputetë dhe ta bëjë verifikimin e votave të subjekteve politike nga formularët të cilët janë plotësuar në vendvotime; numërimin e votave me kusht; votat e personave me nevoja të veçanta dhe votat nga votimi jashtë Kosovës. KQZ është e përkushtuar maksimalisht që të gjitha këto procese të kryhen në kohën më të shpejtë të mundur, por duke siguruar saktësi në evidentimin e vullnetit të çdo votuesi. KQZ sqaron se integriteti i votës nuk është i cenuar dhe pavarësisht prej vonesave që janë shkaktuar si pasojë e problemeve me platformën elektronike, rezultatet përfundimtare do të jenë të sakta dhe të bazuara në vullnetin e qytetarëve të shprehur përmes votës së tyre”, ka thënë Elezi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka ngulur këmbë se integriteti i votës nuk është cenuar dhe se rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, do të jenë të sakta, pavarësisht prej dyshimeve të ngritura pas vonesave gjatë numërimit të votave.

Numërimi i votave të kandidatëve për deputetë të Kuvendit të Kosovës nisi me një ditë vonesë më 11 shkurt vetëm në katër komuna, ndërsa në 34 komunitet e mbetura ka nisur të mërkurën, sipas KQZ-së. Kjo mund ta vonojë shpalljen e rezultateve përfundimtare pasi, pas numërimit të këtyre votave dhe verifikimit të votave për subjektet politike, duhet të numërohen edhe votat jashtë Kosovës, ato me kusht dhe votat e personave me nevoja të veçanta.

Në një njoftim për medie, KQZ-ja tha se derisa numërimi i votave të kandidatëve për deputetë është duke vazhduar pa telashe në Lipjan, Obiliq dhe Partesh, në Prishtinë janë paraqitur probleme “të herëpashershme”. “Procesin e

numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimin e votave të subjekteve politike e kemi filluar gjatë ditës së djeshme në Qendrat Komunale të Numërimit në komunitet: Prishtinë, Lipjan, Obiliq dhe Partesh. Në QKN-të e Obiliqit, Lipjanit dhe Parteshit, procesi i numërimit dhe evidentimit të këtyre rezultateve në platformë elektronike dhe formularët digjitalë është zhvilluar pa ndonjë problem, por në QKN-në e Prishtinës janë paraqitur probleme të herëpashershme”, është thënë në njoftimin e KQZ-së.

Rrjeti i organizatave joqeveritare, Demokracia në Veprim (DnV), i cili e ka vëzhguar fushatën zgjedhore dhe votimin, tha të martën se vonesat “janë të papranueshme dhe dëmtojnë besimin në procesin zgjedhor”. Sipas ligjit në fuqi, në vendvotimet e rregullta, fillimisht numërohen vetëm votat për subjektet politike, ndërsa verifikimi i tyre dhe numërimi i votave për kandidatët e subjekteve politike duhet të nisë ditën pas zgjedhjeve.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ngriti dyshime se mund të ketë “manipulim të votës”, por nuk ka dhënë ndonjë dëshmi. “Raportimet që po marrim nga terreni dëshmojnë për një skemë të organizuar të manipulimit të rezultateve zgjedhore. Përmes kontrollit politik të KQZ-së dhe ‘sistemit të dështuar teknik’ i cili po ndodh qëllimshëm, po tentohet të ndryshohet vullneti i qytetarëve”, tha Haradinaj të

martën.

KQZ-ja i hodhi poshtë këto dyshime nëpërmjet një reagimi të mërkurën, duke thënë se “integriteti i votës nuk është i cenuar dhe, pavarësisht prej vonesave që janë shkaktuar si pasojë e problemeve me platformën elektronike, rezultatet përfundimtare do të jenë të sakta dhe të bazuara në vullnetin e qytetarëve të shprehur përmes votës së tyre”. KQZ-ja ka theksuar se i ka bërë thirrje Prokurorisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera të sigurisë për ta sqaruar situatën dhe për mbështetje teknike pas telasheve të kohëpaskohshme në platformën për rezultatet preliminare që nisën të dielën. “Aktualisht, procesi i numërimit është duke u zhvilluar në këto Qendra Komunale të Numërimit dhe gjatë ditës do të fillojë edhe në qendra të tjera, për të cilat do të njoftojmë. Nisur nga fakti që të dielën në mbrëmje kishte probleme të mosfunksionimit të platformës për rezultatet preliminare, KQZ i ka bërë thirrje Prokurorisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera të sigurisë për ta sqaruar situatën dhe për mbështetje teknike. KQZ-ja është vënë në dispozicion për bashkëpunim me të gjithë aktorët relevantë dhe po punon që të përfundojë numërimi dhe adresimi i çështjeve teknike të mosfunksionimit. Ndërkaq, lidhur me rezultatet preliminare të subjekteve politike dhe të pjesëmarrjes, që gjatë këtyre ditëve janë evidentuar pasaktësi, KQZ njofton se janë duke ndërmarrë të gjitha veprimet për t'i bërë përmirësimet e nevojshme dhe

publiku do të njoftohet me kohë”, ka njoftuar KQZ.

E kur janë numëruar mbi 99 për qind e votave vetëm për subjektet politike, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, i ka fituar 40.81 për qind të votave, sipas KQZ-së.

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, i ka fituar 22.16 për qind të votave, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës i ka siguruar 17.60 për qind të votave.

Koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe NISMA-s fitoi 7.46 për qind të votave.

Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës - i fitoi 4.43 për qind të votave.

Zgjedhjet e 9 shkurtit ishin zgjedhjet e para të rregullta që Kosova ka mbajtur që nga shpallja e pavarësisë.

Vëzhguesit thanë se zgjedhjet ishin të qeta, me disa parregullsi, por pa incidente të mëdha.

Dalja ishte 40.59 për qind me mbi 1.9 milion votuesve me të drejtë vote në Kosovë. Paraprakisht, për këto zgjedhje ka votuar edhe diaspora, nëpërmjet postës, por edhe fizikisht në disa përfaqësi diplomatike të Kosovës në botë.

Kryeziu reagon ndaj deklaratës së Kurtit se “do të kujdesemi për ruajtjen e secilës votë...”

Ndërkaq kryeministri në detyrë dhe lideri i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se “do të kujdesemi për ruajtjen e secilës votë që na e keni besuar”. Ndaj kësaj

Cili është qëndrimi i partive joserbe për qeverinë e ardhshme të Kosovës?

PRISHTINË, 12 SHKURT - Përfaqësues politikë të komuniteteve pakicë joserbe në Kosovë, të cilët, sipas rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë hyrë në Kuvendin e Kosovës, do të mbështesnin - parimisht - cilindo mandatar për formimin e qeverisë së re, pavarësisht nëse do të vinte nga partia aktuale në pushtet, Vetëvendosje, apo nga partitë opozitare.

Disa nga ata me të cilët bisedoi "Radio Evropa e Lirë" kanë kushte për mbështetjen e kandidatit të ri për kryeministër, ndërsa të tjerë nënkuptojnë mbështetje të pakushtëzuar për cilëndo qeveri.

Në bazë të 99 për qind të votave të numëruara, Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin Kurti mori më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, përkatësisht 47 nga 120 vendet parlamentare - megjithatë, jo mjaftueshëm për ta formuar qeverinë e vetme.

Në bazë të rezultateve preliminare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje është partia që ka marrë më së shumti vota. Rezultati përfundimtar i votimeve do ta përcaktojë përbërjen e re të Kuvendit me 120 ulëse, ndërkaq deputetët më pas zgjedhin qeverinë e re. Sipas rezultateve preliminare, Partia Demokratike e Kosovës pritet t'i ketë 25 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës 20 dhe koalicioni i mbledhur rreth Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës 8.

Këto shifra mund të ndryshojnë pas numërimit të votave me kusht dhe të diasporës.

Pas shpalljes së fitores në zgjedhjet e së dielës, Kurti tha se Vetëvendosja do ta formojë në mënyrë të pavarur qeverinë, që do të thotë se votat e komuniteteve pakicë mund të jenë vendimtare për zgjedhjen e saj.

Me shumë mundësi, e ashtuquajtura "qeveri e pakicës" do të formohet edhe nëse mandatar për kryeministër do të ishte dikush nga partitë aktuale opozitare,



sepse për të zgjedhur një qeveri duhen 61 vota. Sipas Kushtetutës së Kosovës, nga gjithsej 120 vende parlamentare në Kuvendin e Kosovës, 20 janë të rezervuara për komunitetet joshumicë - prej të cilave dhjetë për komunitetin serb dhe dhjetë për komunitetet e tjera që jetojnë në Kosovë.

Kështu, komuniteti boshnjak i ka tri ulëse parlamentare, komuniteti turk dy, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE) kanë nga një, një vend shtesë shkon për komunitetin nga radhët RAE që ka fituar më shumë vota, dhe një vend parlamentar i takon komunitetit goran.

Kush nga pakicat ka hyrë në Kuvendin e Kosovës?

Bazuar në rezultatet preliminare të zgjedhjeve, Lista Serbe - partia më e madhe serbe në Kosovë, e cila ka mbështetjen e Beogradit - fitoi nëntë ulëse parlamentare, ndërsa një e fitoi Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiçit, ministër në qeverinë e Albin Kurtit.

Kur bëhet fjalë për dhjetë vendet e garantuara për komunitetet e tjera joshumicë, Partia Demokratike e Turqve të Kosovës fitoi dy ulëse në Kuvendin e Kosovës, ndërsa nga komuniteti boshnjak, Partia e Re Demokratike, Koalicioni Vakati dhe Bashkimi Socialdemokrat fituan nga një

ulëse.

Nisma e Re Demokratike e Kosovës, që përfaqëson komunitetin egjiptian, fitoi një ulëse. Ky komunitet mori më së shumti vota nga RAE, kështu që Partia Liberale e Egjiptianëve fitoi një mandat tjetër parlamentar. Gjithashtu, Partia e Ashkalinjve për Integrim fitoi një ulëse, Partia e Bashkuar Rome e Kosovës një dhe Partia e Bashkuar Gorane një.

Për kë do të votojnë pakicat?

Duda Bale nga Lidhja Socialdemokratike Boshnjake e Kosovës thotë se hyn në Kuvendin e Kosovës për t'i mbrojtur interesat e komunitetit boshnjak dhe se vota e saj e mbështetjes do t'i shkojë kandidatit për kryeministër që do t'i plotësojë kushtet e këtij komuniteti.

Një prej kushteve kryesore, sipas Bales, është formimi i komunës së Zhupës me shumicë boshnjake. Bazuar në regjistrimin e popullsisë në vitin 2024, komuniteti boshnjak në Kosovë është i dyti më i madhi dhe përbën rreth 1.69 për qind të popullsisë së përgjithshme.

Për ta mbështetur Qeverinë e re të Kosovës, Bale thotë se duhet të marrë garanci nga kryeministri i mandatar se do të bëhen më shumë investime në zonat ku jetojnë boshnjakët dhe se do të ketë një reformë të

sistemit arsimor në mësimdhënien në gjuhën boshnjake. "Ne jemi këtu për komunitetin tonë, jemi pakicë. Puna ime dhe detyrimi im moral është ta mbështes komunitetin tim. Për mua është e rëndësishme që vetëm kërkesat e boshnjakëve të vihen në tavolinë dhe të diskutohen. Cilindo mandatar për kryeministër që vjen, do t'i vendosen kushtet", thotë Bale për "Radio Evropa e Lirë".

Rasim Demiri nga Koalicioni Vakati thotë se është ende herët të mendohet se cili kandidat për kryeministër të përkrahët dhe në çfarë kushtesh, por shton se një vendim i tillë do të shqyrtohet me kujdes. "Pasi ta përfundojmë procesin zgjedhor, do të shohim se si dhe në çfarë mënyre do të qasemi. Çdo vendim që merret, do të merret në favor të komunitetit boshnjak", thotë Demiri për "Radio Evropa e Lirë".

Emilija Rexhepi nga Partia e Re Demokratike nuk ishte në dispozicion për koment. Në qeverinë e Kurtit ajo ishte zëvendëskryeministër për komunitetet pakicë.

Albert Kinolli nga Partia e Bashkuar Rome e Kosovës thotë se do t'i japë mbështetje të pakushtëzuar Qeverisë së re të Kosovës, pavarësisht se nga cila parti vjen mandatar për kryeministër. "Për ne është e rëndësishme që të gjitha organet e shtetit tonë të jenë funksionale, sepse populli i Kosovës e meriton. Së dyti, kushdo që do ta krijojë shumicën, ne do të jemi

me të, do të jemi me ata që kanë shumicën për t'i formuar institucionet e Qeverisë së Kosovës", thotë Kinolli për "Radio Evropa e Lirë".

"Radio Evropa e Lirë" nuk arriti të bjerë në kontakt me përfaqësuesit politikë të turqve, ashkalinjve dhe egjiptianëve.

Elbert Krasniqi, nga Nisma e Re Demokratike e Kosovës, e cila përfaqëson komunitetin egjiptian, ishte ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal në Qeverinë e Kurtit, ndërsa partia e tij ka përkrahur Lëvizjen Vetëvendosje në periudhën parazgjedhore.

Kur i fitoi zgjedhjet për herë të parë në vitin 2019, Kurti e formoi qeverinë me mbështetjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Por, pikërisht me iniciativën e këtij partneri të koalicionit, ajo qeveri ra më pak se dy muaj pas formimit për shkak të mosmarrëveshjeve për menaxhimin e pandemisë së koronavirusit.

Partitë aktuale opozitare në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e kanë hedhur poshtë mundësinë e lidhjes së koalicionit me Vetëvendosjen. Një qëndrim i tillë e ka shprehur edhe udhëheqësi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, gjatë fushatës zgjedhore.

Ramush Haradinaj i AAK-së ka dalë edhe me idenë e formimit të qeverisë nga opozita, por ajo nuk është komentuar nga PDK-ja e LDK-ja.

deklarate ka reaguar drejtori i KDI-së, Ismet Kyrëzi. "Situatë paradoksale!? Një parti që ka pasur një mandat të plotë në pushtet dhe ka pasur mundësinë të ndërtojë institucione të pavarura dhe mekanizma për zgjedhje të drejta, të lira e të barabarta, tani po e vë në dyshim integritetin e këtij procesi. Në një demokraci funksionale, partitë në pushtet kanë përgjegjësinë kryesore për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, jo për të ngritur dyshime mbi to!? Në asnjë demokraci nuk është normë që

një parti që ka mbajtur pushtetin për një mandat të plotë të pretendojë për manipulim zgjedhor, sepse kjo do të thoshte se ajo ose nuk ka arritur të sigurojë një proces zgjedhor të besueshëm, ose po bën përpjekje për të ndërthurr një narrativë për justifikimin e një rezultati të pafavorshëm. Në të dyja rastet, kjo cenon besimin e qytetarëve në procesin demokratik dhe mund të krijojë kriza e precedentë me dëme afatgjata për zgjedhjet në Kosovë", ka shkruar në "Facebook" Kyrëzi.

BE-ja: Mezi presim formimin e Qeverisë së re të Kosovës dhe vazhdimin e angazhimit tonë me autoritetet

Bashkimi Evropian (BE) ka thënë se mezi pret formimin e Kuvendit dhe Qeverisë së re të Kosovës pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, të cilat i cilësoi si paqësore dhe konkurruese. Në një komunikatë të përbashkët më 11 shkurt, shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, Kaja Kallas, dhe

komisionarja për Zgjerim në BE, Marta Kos, thanë se do ta "vazhdojmë angazhimin tonë me autoritetet, me qëllim mbështetjen e Kosovës për t'u afruar më shumë me BE-në dhe për të përfitur plotësisht nga mundësi të rëndësishme si Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor".

BE-ja pret që Qeveria e re e Kosovës të angazhohet në bashkëpunim të përgjegjshëm rajonal dhe t'i rrisë përpjekjet për forcimin e sundimit të ligjit dhe administratës publike, si dhe për mbrojtjen e lirisë së shprehjes,

thuhet në komunikatë.

BE-ja, gjithashtu, përsëriti se përparimi në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është e vetmja mënyrë për Kosovën për të ecur përpara në rrugën e saj evropiane. "Prej Kosovës pritet t'i zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit, si dhe nga të gjitha marrëveshjet e mëparshme të dialogut, pa vonesa të mëtejshme dhe pa parakushte. Nuk ka zgjidhje tjetër mos dialogut të lehtësuar nga BE-ja", thuhet tutje në komunikatë.

Komuna e Rahovecit dhe DEMOS-i nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

RAHOVEC, 12 SHKURT - Komuna e Rahovecit ka nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit me DEMOS-in për të forcuar

transparencën buxhetore dhe përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen lokale. Sipas njoftimit të kësaj komune, ky partneritet do të ndihmojë në

planifikimin e hershëm buxhetor, konsultimet publike dhe përdorimin e platformave digjitale. "Falënderojmë DEMOS-in

për mbështetjen në ndërtimin e një qeverisjeje më të hapur dhe më efektive për qytetarët tanë!", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



Zgjedhjet prodhuan krizë politike



Shkruan: Astrit GASHI

Zgjedhjet kanë përfunduar dhe rezultati tashmë dihet. Megjithatë, ky rezultat ka krijuar një situatë të ndërlikuar politike, ku as pozita dhe as opozita nuk kanë një shumicë të qartë për të formuar qeverinë. Kjo do të thotë se krijimi i një ekzekutivi të ri do të jetë një proces i vështirë dhe, me shumë gjasa, nuk do të ndodhë para pranverës.

Ky rezultat është pasojë e

dështimit të pozitës për të realizuar premtimet e saj, si dhe e paaftësisë së opozitës për t'u reformuar dhe ofruar një alternativë bindëse. Në vend që të sillnin një ofertë të re politike, partitë opozitare konkurruan me të njëjtat klane dhe figura të vjetra, të cilat nuk arritën të fitojnë besimin e elektoratit për të ndërtuar një qeveri të re.

Nga ana tjetër, ndarja e votave dhe mungesa e një shumice të qartë ka bërë që formimi i qeverisë të varet nga llogaritjet politike dhe marrëveshjet mes partive, të cilat deri më tani duken shumë të vështira.

Një koalicion i madh mes forcave kryesore politike është pothuajse i pamundur pa ndërhyrjen e faktorëve ndërkombëtarë. Për të siguruar një shumicë prej të paktën 61 votash për qeverinë

e re, partitë duhet të përfshijnë edhe minoritetet joserbe, por kjo është një sfidë për shkak të ndarjeve të thella mes partive dhe mungesës së një konsensusi të gjerë.

Në këto rrethana, Vetëvendosje (VV) ka mundësinë që të prolongojë procesin e zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit, duke bllokuar kështu gjithë zinxhirin institucional. Kjo është e mundur për shkak të interpretimeve të diskutueshme të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka ndërhyrë disa herë në proces pa dhënë afate kohore të qarta.

Kjo krijon terren për një krizë të zgjatuar institucionale, ku as nuk formohet qeveria, as nuk shpallen zgjedhjet e reja, duke futur vendin në një situatë të pasigurt politike. Një tjetër faktor që rëndon

situatën është fakti se pas një viti duhet të zgjidhet edhe Presidenti i vendit, një proces që në këto kushte është pothuajse i pamundur. Zgjedhja e Presidentit kërkon 81 vota në Kuvend, një shumicë që asnjë parti nuk e ka dhe që është shumë e vështirë të arrihet pa një marrëveshje të gjerë politike. Në këtë kontekst, për të siguruar stabilitet politik, Kosova ka vetëm një opsion realist: një koalicion mes Vetëvendosjes dhe njëres nga dy partitë e mëdha opozitare PDK ose LDK.

Një koalicion mes VV (47) dhe PDK, e cila ka rreth 25 deputetë, do të kishte më shumë gjasa për të arritur shumicën e nevojshme për zgjedhjen e Presidentit dhe krijimin e një qeverie stabile. Një koalicion mes VV dhe

LDK, e cila ka rreth 20 deputetë, do të ishte një opsion më i brishtë, pasi nuk do të garantonte shumicën prej 81 votash për zgjedhjen e Presidentit.

Nëse këto dy opsione dështojnë, Kosova do të përballet me një krizë të vazhdueshme, ku qeveria mund të jetë jofunksionale dhe zgjedhjet e reja do të jenë të pashmangshme, por pa siguri se do të sjellin një rezultat më të qartë se ky aktual.

Në fund, zgjedhjet nuk e prodhuan vetëm rezultatin, por edhe krizën. Dhe tani, fati i institucioneve të Kosovës nuk varet më vetëm nga vullneti i partive politike, por edhe nga presioni ndërkombëtar dhe nga gatishmëria për të bërë kompromis.

Kastrati takon zëvendëskomandantin e KFOR-it, në fokus të takimit siguria në Malishevë

MALISHEVË, 12 SHKURT - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka pritur të mërkurën në takim zëvendëskomandantin e KFOR-it, gjeneralbrigade Cahit Irican. Gjatë takimit ata diskutuan mbi bashkëpunimin mes KFOR-it dhe komunës, me fokus në sigurinë dhe mbështetjen e ndërsjellë.

Kryetari Kastrati e falënderoi gjeneralin Irican për vizitën dhe vlerësoi kontributin e KFOR-it në ruajtjen e sigurisë dhe mbështetjen ndaj institucioneve komunale.

Nga ana tjetër, gjeneralbrigade Cahit Irican e falënderoi kryetarin Kastrati për pritjen dhe e vlerësoi lart bashkëpunimin mes KFOR-it dhe komunës, duke theksuar rëndësinë e njëjësive të tyre në terren.

Të dyja palët u zotuan për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së përgjithshme.



Haxhiu nënshkruan udhëzimin administrativ për Fondin Emergjent për Nevojat e Viktimave

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ministria në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se ka nënshkruar udhëzimin administrativ, me

anë të të cilit krijohet Fondi Emergjent për Nevojat e Viktimave. Ajo ka thënë se ky fond ka për qëllim të sigurojë që viktimat e dhunës në

familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore, gjatë qëndrimit të tyre në polici, të kenë qasje në shërbimet e nevojshme. "Po ashtu, ky

mekanizëm garanton që ndihma për viktimat e dhunës të ofrohet në mënyrë të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë", ka thënë Haxhiu.



Rezultati i zgjedhjeve s'e përjashton mundësinë e krizës institucionale

Analistët thonë se do të duhen së paku dy muaj apo dy muaj e gjysmë për të kuptuar nëse do të ketë qeveri të re, apo vendi do të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 12 SHKURT - Derisa Kosova përpunon ende rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, analistët politikë tërheqin vërejtjen se vendi mund të rrëshqasë drejt krizës institucionale. Kjo krizë bën që institucionet e shtetit të mos funksionojnë normalisht dhe të mos arrijnë t'i përmbushin detyrat e tyre kushtetuese dhe ligjore. "Unë nuk shoh mundësi që Qeveria e Kosovës të formohet së shpejti", thotë për "Radion Evropa e Lirë", Donika Emini nga Grupi Këshillëdhënës në Evropë për Politikën e Ballkanit, "për shkak se partitë duhet të ulen të negociojnë dhe negociatat do të marrin shumë kohë. Nuk pritët të jetë një proces i lehtë", sipas saj.

Çfarë sollën zgjedhjet e 9 shkurtit?

Me mbi 99 për qind të votave të numëruara, Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin Kurti prin me rreth 40 për qind të votave, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me rreth 22 %, Lidhja Demokratike e Kosovës me rreth 17 % dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - Nisma me rreth 7 %.

Për formimin e qeverisë së re, partia fituese duhet t'i ketë 61 deputetë, e që aktualisht asnjëra nuk i ka.

Shifrat, megjithatë, mund të ndryshojnë pas numërimit të votave me kusht dhe të diasporës.

Në mandatin e kaluar katërvjeçar, Kurti ka qeverisur me partitë e pakicave joserbe. Pas shpalljes së fitores në zgjedhjet e 9 shkurtit, ai ka shprehur bindjen se Vetëvendosja e tij do ta formojë qeverinë në mënyrë të pavarur.

Pas zgjedhjeve, partitë, tash në opozitë, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kanë përjashtuar mundësinë e koalicionit me Vetëvendosjen. Gjatë fushatës parazgjedhore një mundësi të tillë e ka hedhur poshtë edhe Lidhja

Demokratike e Kosovës. Ramush Haradinaj i AAK-së ka shpalosur edhe idenë e formimit të qeverisë nga opozita, por nuk ka marrë përgjigje prej PDK-së e LDK-së.

Disa përfaqësues të partive të komuniteteve pakicë, ndërkaq, kanë thënë se do ta mbështesnin parimisht cilindo mandatar për formimin e qeverisë së re.

"Pritje edhe dy-tre muaj apo më gjatë"

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë se ka rrezik real që Kosova të futet në krizë institucionale. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai vë në pah retorikën fyese dhe dëbuese që, sipas tij, përdor para të gjithëve kryeministri Kurti.

Në fjalimin pas fitores, Kurti ka përdorur shprehje denigruese në drejtim të partive opozitare. "Ato mund të kuptohen si mesazh që Lëvizja Vetëvendosje nuk ka asnjë dëshirë, në asnjë rrethanë, që të bëjë koalicion me partitë shqiptare. Kjo është një mënyrë e përçarjes", thotë Miftaraj.

Ai shton se do të duhen së paku dy muaj apo dy muaj e gjysmë për të kuptuar nëse do të ketë qeveri të re, apo vendi do të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Në tryezë të bisedimeve, thotë ai, do të jenë matematika të ndryshme. Ai nuk e përjashton mundësinë që partitë shqiptare në opozitë ta formojnë qeverinë e re, duke bërë pjesë të koalicionit komunitetor joshumicë - pa serbët.

Emini ka pritur të ngjashme - ajo mendon se nuk do të ketë formim të qeverisë së re së paku deri në verë, marrë parasysh rezultatet që kanë prodhuar zgjedhjet. "Fjalimi toksik ndaj opozitës tregon që Kurti, në njëfarë mënyre, e kishte për qëllim që ta antagonizonte opozitën dhe ajo t'i refuzonte negociatat me të... Por, edhe për opozitën është e vështirë, sidomos për



LDK-në, e cila ka qenë në koalicion [me Kurtin] dhe ka përjetuar rënien me të madhe gjatë asaj kohe", thotë Emini.

As ajo nuk e përjashton mundësinë e shkuarjes në zgjedhje të reja, nëse partitë nuk arrijnë të pajtohen, por thotë se ato nuk do të ishin zgjidhje e mençur, marrë parasysh se Kosova, këtë vit, mban edhe zgjedhjet lokale.

"Unë nuk mendoj se përsëritja e zgjedhjeve mund të sjellë ndonjë rezultat. Ajo që mund të sjellin zgjedhjet e tilla, është mosadalja e qytetarëve dhe kështu do të përsëritej një proces me rezultate të ngjashme. Do të ishte humbje kohe dhe humbje e jashtëzakonshme e resurseve", thotë Emini. Sipas saj, Kosova nuk e ka luksin për zgjedhje të tilla edhe për shkak të dinamikave në botë dhe pritjeve prej saj, sidomos sa i përket rinisjes së dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

"Brendapërbrenda, ndoshta do të mund të funksiononim disi, mirëpo në politikën e jashtme do të kishim pasoja serioze", thotë Emini.

Çfarë ndodh tash?

Në Ligjin për Zgjedhjet në Kosovë nuk është i përcaktuar ndonjë afat kohor se kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i shpallë rezultatet përfundimtare. Deri më tash janë evidentuar disa shkelje në procesin e numërimit të votave për kandidatët për deputetë, si

dhe ka pasur pengesa të qasjes në uebfaqen e KQZ-së. Kurdo që të bëhet numërimi i të gjitha votave nga KQZ-ja dhe certifikimi i rezultateve, presidentja e Kosovës thërret seancën konstituive të Kuvendit brenda 30 ditësh nga shpallja e rezultateve. Deputetët betohen dhe zgjedhin kryetarin e Kuvendit dhe nënkryetarët.

Pas kësaj procedure, presidentja i jep mandatin për formimin e qeverisë kandidatit të propozuar nga partia ose koalicioni fitues.

Kandidati për kryeministër propozon përbërjen e qeverisë dhe programin qeverisës.

Qeveria votohet nga Kuvendi me shumicën e thjeshtë të votave (50 % + 1 deputetë të pranishëm).

Sipas Nenit 95 të Kushtetutës së Kosovës, nëse përbërja e propozuar e qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë ditësh emëron kandidatit tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet qeveria, atëherë presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet ditë nga dita e shpalljes së tyre.

A ka pasur kriza më herët?

Kosova ka pasur disa bllokada institucionale, kryesisht për shkak të mungesës së konsensusit politik. Një e tillë ndodhi pas zgjedhjeve të

përgjithshme të vitit 2014. Atëkohë PDK-ja që doli e para nuk arriti ta siguronte shumicën për krijimin e qeverisë.

Koalicioni opozitar LDK-AAK-Nisma e sfidoi të drejtën e PDK-së për ta propozuar kryetarin e Kuvendit, por Gjykata Kushtetuese vendosi në favor të PDK-së dhe e detyroi koalicionin opozitar të bënte marrëveshje me PDK-në.

Pas disa muajsh bllokadë u arrit një marrëveshje për bashkëqeverisje mes PDK-së dhe LDK-së, që e solli Isa Mustafën në postin e kryeministrit.

Në vitin 2020 kishte, po ashtu, një krizë pas rrëzimit të qeverisë së parë të Kurtit. Në mars të atij viti, vetëm pas disa javësh në detyrë, qeveria e tij u rrëzua pas një mocioni të mosbesimit, të iniciuar nga partnerja e koalicionit, LDK.

Presidenti i atëhershëm, Hashim Thaçi, i dha mandatin për formimin e qeverisë Avdullah Hotit nga LDK-ja, pa shpallur zgjedhje të reja.

Megjithatë, kjo qeveri u përball me sfida të mëdha politike dhe ligjore dhe, pas disa muajsh, u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese në fund të vitit 2020, për shkak të një votimi jokushtetues nga deputeti Etem Arifi.

Zgjedhjet e reja u mbajtën në shkurt të vitit 2021 dhe Vetëvendosja fitoi mbi 50 për qind të votave.

Zgjedhjet e 9 shkurtit ishin të parat të rregullta që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës më 2008.

Ministri Maqedonci po merr pjesë në takimin e radhës së Grupit të Kontaktit për Ukrainën

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, po merr pjesë në takimin e Grupit të Kontaktit për Ukrainën, i cili

po mbahet në selinë e NATO-s. Diskutimet kryesore fokusohen në situatën e sigurisë globale dhe mbështetjen

ndërkombëtare për Ukrainën. Grupi i Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës është formati i takimeve të ministrave dhe shefave të

mbrojtjes së mbi 50 vendeve të botës që përbëjnë koalicionin e madh të mbështetësve të Ukrainës që prej fillimit të agresionit rus.



Ndërmarrësit e Kosovës përfitojnë nga punëtorja për edukim financiar

PRISHTINË, 12 SHKURT - Punëtorja për Edukimin Financiar për Ndërmarrësit synon t'i rrisë aftësitë financiare të ndërmarrësve të Kosovës, veçanërisht të bizneseve të vogla dhe të mesme. Kështu u tha në ngjarjen e organizuar në kuadër të platformës "Biznesi im", me mbështetjen e projektit EnInGeP, në bashkëpunim me Raiffeisen Bank Kosovo dhe KIESA. Punëtorja u hap nga Durim Hoxha, nga projekti EnInGeP, i cili theksoi rëndësinë e zhvillimit të aftësive financiare në mesin e ndërmarrësve për rritjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin ekonomik të bizneseve në Kosovë. Ai vuri theksin te roli kyç që kjo punëtorja luan në përmirësimin e aftësive të pjesëmarrësve, veçanërisht të bizneseve të udhëhequra nga gratë, duke ofruar njohuri praktike për menaxhimin financiar dhe qasjen në financim. Punëtorja përfshiu një seri temash thelbësore për ndërmarrësit, duke u fokusuar në menaxhimin e suksesshëm

të financave të një biznesi. Prezantimi i parë u mbajt nga Mic Ukaj, i cili shpjegoi në detaje mbi bilancin e gjendjes, pasqyrën e fitimit dhe humbjes, rrjedhën e parasë. Ai u fokusua në rëndësinë e buxhetimit dhe planifikimit financiar për ta siguruar qëndrueshmërinë e biznesit dhe ndërgjegjësimin për obligimet tatimore. Më pas, Besian Demiri nga Raiffeisen Bank Kosovo ka diskutuar mbi qasjen në financim të jashtëm, duke përfshirë përgatitjet e një biznesi për qasjen në kredi, si dhe menaxhimin e kredive, një element thelbësor për rritjen e qëndrueshmërisë së bizneseve të vogla dhe të mesme. Për sigurimin e bizneseve, Astrit Veseli paraqiti produktet e sigurimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), duke theksuar mënyrën se si sigurimet mund të mbrojnë asetet dhe operacionet e bizneseve nga rreziqe të ndryshme. Një nga temat më interesante u paraqit nga Sytrime Dervisholli, e cila trajtoi




rëndësinë e Kriteve Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes (ESG) dhe rolin e tyre në financimin e qëndrueshëm të bizneseve. Ajo shpjegoi se si bizneset që ndjekin këto kriterë kanë një mundësi më të mirë për të tërhequr financime dhe për të siguruar rritje të qëndrueshme afatgjatë. Punëtorja u vlerësua shumë

nga pjesëmarrësit, të cilët morën njohuri të vlefshme për ta përmirësuar menaxhimin e financave të bizneseve të tyre dhe për të përfutur më mirë nga mundësitë e financimit. Platforma "Biznesi Im", në bashkëpunim me partnerët e saj, do të vazhdojë të ofrojë mundësi të tilla trajnimesh dhe aktivitete për të ndihmuar në rritjen e

kapaciteteve të ndërmarrësve në Kosovë. Projekti EnInGeP, i financuar nga Austrian Development Cooperation dhe i implementuar në bashkëpunim me CARE International dhe ECIKS, mbështet vazhdimisht iniciativat që synojnë rritjen e mundësive ekonomike për ndërmarrësit e Kosovës.

Në nderim të 80-vjetorit të gazetës 'Rilindja', Posta vë në qarkullim postar emisionin e ri të pullave postare

PRISHTINË, 12 SHKURT - Më 12 shkurt, Posta e Kosovës, përmes Filatelistë së saj, në nderim të 80-vjetorit të gazetës "Rilindja", ka vënë në qarkullim postar emisionin e ri të pullave postare. Ky emision i pullës postare rendit kontributin e gazetarëve, redaktorëve dhe gjithë punonjësve të medias së parë të shkruar në Kosovë "Rilindja", që nga botimi i numrit të parë të gazetës më 12 shkurt 1945. Botimi i numrit të parë të gazetës kërkonte shumë përkushtim dhe punë, megjithatë falë angazhimit të madh të punonjësve u arrit që shkronjat e gjuhës shqipe të punoheshin manualisht, në mënyrë që gazeta "Rilindja" të ishte në duar të lexuesve nga 12 shkurti i vitit 1945. "Kontributi i gazetës 'Rilindja' nuk kufizohet vetëm në fushën e informacionit, pasi që nga viti 1946, bëhet bartëse e aksioneve



të shumta për zhdukjen e analfabetizmit dhe të fushatave për arsimimin e gruas. Me bartjen e shtypshkronjës në

Prishtinë në vitin 1958, rritet edhe numri i botimeve, kur gradualisht "Rilindja" shndërrohet në gazetë ditore,

thuhet në njoftimin e Postës së Kosovës. Më tutje, theksohet se në periudhën e territ informativ të

vitet '90, si rezultat i masave të dhunshme, më 8 gusht 1990 u ndalua publikimi i gazetës "Rilindja". Megjithatë, më 18 janar 1991 punonjësit e uzurpuar arritën ta vazhdojnë informimin e opinionit vendor dhe ndërkombëtar përmes përdorimit të emërimit të gazetës "Bujku". "Kontributi i jashtëzakonshëm i të gjithë gazetarëve, redaktorëve dhe punonjësve entuziast për tejkalimin e sfidave në mënyrë që gazeta 'Rilindja' të arrijë në duar të lexuesve, ka qenë dhe mbetet vlerë e paçmuar në ruajtjen e identitetit kombëtar, si dhe promovimit të vlerave të lirisë e demokracisë", vijon njoftimi. Posta e Kosovës shton tutje se ky shënim jubilar le të shërbejë për të reflektuar mbi rolin dhe ndikimin e gazetës "Rilindja" si forcë, motivim dhe shtysë për ta vijuar misionin e saj fisnik në të ardhmen.

Më 19 shkurt mbahet ankandi i dytë i letrave me vlerë për vitin 2025

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 19 shkurt 2025 do të mbahet ankandi i dytë i letrave me vlerë për vitin 2025. Sipas një njoftimi për medie në këtë

ankand, do të emetohen obligacione me maturitet dyvjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. Më tutje, në njoftim thuhet se investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar

me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohehet për të gjithë kohëzgjatjen (dy vjet) dhe është tërësisht i liruar nga

tatimi. "Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", thuhet në njoftim.



Origjina e njohjeve përmes kompjuterit



Nga: Aine QUINN / BBC

Sipas historianes Francesca Beaumanit, në vitin 1788, një burrë me emrin "AB" vendosi njoftimin e parë personal të njohur në Nju-Jork, në gazetën Impartial Gazetteer. Ai kërkonte një grua "nën moshën 40-vjeçare, jo të deformuar dhe me të paktën një mijë paundë". Duke e përshkruar veten si "një zotëri i ri me familje dhe pasuri, i sapoardhur në qytet", njoftimi i tij mund të konsiderohet si biografia e Tinder-it e asaj kohe. Nuk dihet nëse AB mori ndonjë përgjigje, por pothuajse 200 vjet më vonë, Nju-Jorku u bë vendlindja e një qasjeje tjetër novatore ndaj takimeve – kombinimi i çifteve përmes kompjuterit. Krijuar nga Bob Ross (programues kompjuterik në IBM, jo piktori) dhe kontabilisti Lewis Altfest, Tact – ose Technical Automated Compatibility Testing [Testimi i Automatizuar Teknik i Përputhshmërisë] – u lansua në Nju Jork 60 vjet më parë, në vitin 1965. Fillimisht i kufizuar në Anën e Sipërme Lindore [Upper East Side], shpejt u zgjerua në të gjithë qytetin dhe mijëra njerëz u regjistruan që kompjuteri të gjente se me kë përputhen. Sipas Rossit, çdo person i interesuar duhej të paguante pesë dollarë dhe të plotësonte një pyetësor i cili më pas përdorej për të krijuar përputhje "në tri nivele": faktorë socio-kulturorë, mendime dhe vlera, si dhe faktorë psikologjikë. Përgjigjet përpunoheshin nga kompjuteri, i cili nxirrte përputhjen e supozuar me gjininë e kundërt. Takimet mes personave të së njëjtës

gjini nuk ishin në opsion. "Tact nuk është një klub për zemra të vetmuara", ka thënë tha Ross për emisionin Tomorrow's World të BBC-së. "Nuk është një agjenci martesash. Është një mënyrë e re dhe argëtuese për të njohur njerëz të rinj". Ai theksoi se shërbimi ishte i hapur për "të gjithë njerëzit që duan të argëtohen, nga 18 deri në 45 vjeç", dhe shtoi: "Njerëzit hyjnë në Tact për arsye të ndryshme. Disa thjesht duan të njohin njerëz të rinj dhe të dalin në takime ... disa të tjerë kërkojnë diçka më serioze, duan të krijojnë një marrëdhënie të qëndrueshme, dhe pastaj ka ata që duan të martohen".

Pyetjet e pyetësorit të Tact u miratuan nga psikologu Dr. Salvatore V. Didato, i cili besonte se ekzistonte "një nevojë e madhe sociale" për shërbimet si kjo. Ai kritikoi shërbimet e tjera të njohjeve duke thënë: "Pretendojnë se përputhin njerëzit bazuar në shumë variabla, por në fund rezultojnë se i përputhin vetëm sipas moshës, gjinisë, fesë dhe gjatësisë, apo diçkaje të ngjashme". Pyetësori i Tact-it shkonte më tej, duke përfshirë një seri pohimesh, me të cilat pjesëmarrësit duhej të pajtoheshin ose të mos pajtoheshin. Në një raport të BBC-së, një klient tipik dha këto përgjigje: "Më shqetësojnë marrëdhëniet e mia me njerëzit – po. Më pëlqejnë njerëzit që shprehin haptazi dashurinë – po. Shumicën e kohës veproji si një person i pavarur – jo. Më pëlqen të shkoj në festa – po". Megjithëse Tact ishte pjesë e një vale të re teknologjike, nuk ishte shërbimi i parë i takimeve me ndihmën e kompjuterit. Dy krijuesit e tij

ishin frymëzuar nga Operation Match, një shërbim i nisur më herët atë vit nga studentët të Harvardit – dekada përpara se studentët e tjerë të të njëjtit universitet të krijonin një mënyrë tjetër të fuqizuar nga kompjuteri për t'i lidhur njerëzit: Facebook-un.

Në vitin 1965, kompjuterët ishin ende një risi. Operation Match duhej të mernte me qira një nga kompjuterët e universitetit për 100 dollarë në orë. Shërbimi u bë shpejt popullor, me mijëra studentë që dërgonin pyetësorët e tyre. "Ti mendoje se kompjuteri ishte Zoti, dhe se kompjuteri dinte gjithçka", tha bashkëkrijuesi Jeff Tarr për Witness History të BBC-së në vitin 2014. Për habi, vajza e Tarrit më vonë u martua me një nga krijuesit e Match.com, një nga faqet e para të njohjeve në internet. Kompjuteri ofroi një ndjenjë sigurie: në vend që të mbështetesh te fati për të gjetur partnerin/partneren e duhur, tani mund të përputheshe në mënyrë algoritmike me shpirtin tënd binjak.

Vitet '60 të shekullit XX ishin kohë revolucionari. Në Shtetet e Bashkuara, lëvizja për të drejtat civile dhe feminizmi i valës së dytë ishin në kulm. Normat shoqërore po ndryshonin, dhe teknologjia po zhvillohej me shpejtësi: ardhja e kompjuterit përkohe me një shoqëri gjithnjë e më të hapur. Deri në vitin 1969, takimet me ndihmën e kompjuterit – ose të paktën ideja për këtë – ishin bërë aq të zakonshme sa që u shfaqën si pjesë e një episodi të serialit të famshëm Bewitched. Serena, kushërira e Samantës (të dyja të luajtura nga Elizabeth Montgomery), regjistrohet në një shërbim takimesh për të gjetur një bashkëshort të

vdekshëm, por përfundon duke u përputhur me një magjistar! Vetë Bob Rossi e gjeti dashurinë përmes Tact-it – edhe pse jo falë kompjuterit. Sipas një artikulli të The New Yorker-it të vitit 2011, ai më vonë u martua me një gazetare që e intervistoi atë për projektin.

Mijëra klientët e gatshëm të Tact-it sinjalizuan një largim nga kultura më formale e takimeve të gjysmës së parë të shekullit dhe një kalim drejt qëndrimeve më moderne. Megjithatë, nuk zgjatën shumë këto shërbime të hershme të përputhjes me kompjuter. Ndërsa disa njerëz gjetën partnerin e tyre ideal, shërbimet kishin disa mangësi fatale. Për shkak se shërbimet kishin për qëllim kryesisht studentët dhe të diplomuarit e klasës së mesme, ekzistonte një grup i kufizuar i përputhjeve të mundshme. Gjithashtu, sistemi ishte i ngadaltë dhe joefikas – mund të duheshin javë të tëra nga momenti kur dërgoje pyetësorin deri kur merrje përputhjet, të cilët pastaj duhej t'i kontaktoje me telefon ose postë. Festat e organizuara nga Tact-i ishin një përpjekje për të afruar ata që përputheshin, pavarësisht distancave që mund të përfshiheshin. Por, edhe kjo mund të ishte e sikletshme. Raporti i BBC-së vërejti se "asnjë ekspert i pranishëm, i marrëdhënieve me publikun, nuk arriti ta gjallëronte festën para se të bëhej terr", pavarësisht një çmimi për çiftin më të përputhur për "një natë e madhe jashtë në qytet". Ndoshta pankarta e thjeshtë e varur mes dy koshave të mbeturinave nuk i dha shumë besueshmëri këtij shërbimi! Edhe pyetjet e pyetësorit lanë shumë për të dëshiruar. Përveç pyetjeve të zakonshme mbi

demografinë dhe pëlqimet, seksioni i "mospëlqimeve" përfshinte opsione si "homoseksualët" dhe "çiftet ndër-racore". Pyetësori luajti gjithashtu me stereotipat: sipas New Yorker-it, burrave iu kërkua të renditnin modelet e flokëve të grave, ndërsa gratë mund të specifikonin se ku mund të gjenin burrin e tyre ideal: duke prerë dru, duke pikturuar në studio ose në një garazh.

Megjithëse krijuesit e Tact-it ishin krenarë për sistemin e tyre me "tri nivele" të përputhshmërisë, shigjetat e tyre të Cupidonit nuk ishin gjithmonë në shënjestër. "Përputhëm një vëlla të madh me motrën e tij më të vogël", pranoi Ross. "Kjo nuk shkoi edhe aq mirë". Ai gjithashtu tha se kishin "disa njerëz që nuk ishin shumë të kënaqur pasi dolën në takime". Në Tomorrow's World, një kliente e mundshme pyeti Dr. Didato mbi saktësinë e sistemit, pas një eksperience të keqe me një shërbim tjetër: "Ajo specifikoi një kufi moshe dhe mori një burrë 20 vjet më të madh"! Pavarësisht mangësisë të Tact-it, Operation Match-it dhe shërbimeve të ngjashme, njerëzit vazhdojnë ta përdorin teknologjinë për të ndihmuar në gjetjen e dashurisë – nga njoftimet personale në gazeta e deri te shërbimet e takimeve me video, nga faqet e njohjeve në internet te aplikacionet e ndihmuara nga intelijenca artificiale. Sipas një studimi nga Pew Research, një në 10 persona që kishin një partner në ShBA në vitin 2023, e kishte takuar atë përmes njohjeve në internet. Kur bëhet fjalë për çështjet e zemrës, duket se nuk mund t'i rezistojmë inovacionit të radhës. /Telegafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Emërllahu: Dua titullin e kampionit me Clujin

Lindon Emërllahu u paraqit edhe zyrtarisht të martën nga CFR Cluj, të cilit iu bashkua për 700 mijë euro nga Ballkani. Futbollisti më i mirë i vitit 2024

në Kosovë ka folur për herë të parë si futbollist i ri i Clujit, me të cilin synon ta ketë një përvojë të suksesshme. "Jam i lumtur që jam këtu, në një klub

të madh si CFR Cluj, i cili vit pas viti gjendet në krye të tabelës. E kam përcjellë skuadrën në këtë sezon dhe dua që së bashku të kemi

momente të mira. Do të jap gjithçka nga vetja për ekipin, për tifozët dhe për këto ngjyra që t'ia dalim të jemi kampionë sërish", ka thënë Emërllahu.



Kualifikohen Llapi, Malisheva, Vëllaznimi dhe Drita

"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 SHKURT - Pas Drenicës, të mërkurën kualifikimin në çerekfinale të Kupës së Kosovës e kanë siguruar edhe Llapi, Malisheva, Vëllaznimi dhe Drita. Skuadra e Llapit, që po kalon nëpër një krizë rezultatesh në Superligë, arriti të kualifikohet tutje në garën e Kupës pasi e mposhti Vushtrinë me rezultat 2-0. Në minutën e 13-të Erdin Dushi shënoi autogol për rezultatin 1-0, derisa në fillim të pjesës së dytë realizoi Elvir Gashijani për rezultatin final 2-0. Malisheva e mposhti Dinamon e Ferizajt me rezultat 2-0 dhe u kualifikua në çerekfinale të Kupës. Golat për skuadrën fituese i realizuan Arlind Veliu (31') dhe Drilon Hazrollaj (40'). Skuadra e tretë që e siguroi kualifikimin është Vëllaznimi i Gjakovës. Kuqezinjtë e mposhtën Gjilanin me rezultat 2-1. Për skuadrën që bën gara në Ligën e Parë të Kosovës, golat i realizuan Viktor Kuka (23') dhe



Norik Krasniqi (75'), derisa mysafirët krejt çka arritën ishte goli i shënuar në minutën e 86. Ndryshe nga Gjilani, skuadra tjetër nga ky qytet, Drita, është dashur të dërsitet mirë për ta siguruar kualifikimin. Kjo skuadër e mposhti vetëm pas

penalltive skuadrën e Dukagjinit të Klinës (5-4), pasi koha e rregullt dhe vazhdimet nuk sollën gola. Të enjten do të zhvillohen dy ndeshjet e tjera të këtij rrethi dhe përballen Ferizaj - Rilindja dhe Feronikeli - Prishtina e Re.

SHKURT

Besa e Kavajës përjashton Mazrekajn

Mentor Mazrekaj ka mbetur pa skuadër, pasi është përjashtuar nga Besa e Kavajës. Vendimin për largimin e futbollistit të Kosovës e ka marrë presidenti i klubit, Nexhat Bizhdili, i cili për "Panorama Sport" tha se lojtari i ka thyer disa rregulla. "Të dy lojtarët kanë thyer në mënyrë të përsëritur disiplinën në ekip. Mentor Mazrekaj për mbi 13 ditë mungoi dhe nuk u paraqit në stërvitje. Krahas saj, ai nuk u impenjua në fushë, ashtu sikurse i takonte", u shpreh Bizhdili. Madje presidenti i klubit shqiptar i ka kërkuar lojtarit t'i kthejë 10 mijë euro. Kujtojmë që Mazrekaj u transferua te Besa gjatë vitit 2024 nga ekipi i Strugës së Maqedonisë. Mazrekaj në të kaluarën ka luajtur edhe për klubet e Kosovës si: Prishtina, Ferizaj, Llapi dhe 2 Korriku.

Më 15 shkurt organizohet turneu i boksit 'Pavarësia'

Federata e Boksit e Kosovës (FBoxK) do ta organizojë turneun e 17 ndërkombëtar "Pavarësia", i cili do të mbahet më 15 shkurt në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. FBoxK-ja ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin sa më të mirë të këtij turneu, i cili nga viti në vit po bëhet edhe më masiv dhe cilësor. Pjesëmarrëse do të jenë Bullgaria, Maqedoni e Veriut, Shqipëria dhe Kosova. Selektori Faton Xhakli ka bërë përzgjedhjen e boksierëve që do ta përfaqësojnë Kosovën. Duelet do të zhvillohen me fillim nga ora 13:00. Gjyqtarë do të jenë Agim Shala, Agim Tahiraj, Fadil Bektashi, Visar Ibrahimimi, Granit Qorri, Filip Nue, Visar Rexhepi, Dalina Baraliu. Nadir Shllaku do të jetë delegat, kurse mjek kujdestar Agron Kamberi.

Tirana mposht Prishtinën

Tirana ka fituar sfidën kryeqytetase ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 77:69 (17:12, 12:19, 26:25, 22:13), në javën e tretë të Ligës Unike. Tiranasi ishin më të mirë në çerekun e parë 17:12, derisa e kundërta ndodhi në periudhën e dytë, me prishtinasit që ishin më

të mirë, 12:19, për të shkuar në pushim me rezultat 29:31. Perioda e tretë ishte e baraspeshuar, 26:25, ku fituesi u vendos në dhjetë minutat e fundit. E në këtë pjesë tiranasit ishin më të mirë, 22:13, duke triumfuar 77:69. Te Tirana u dallua Endrit Hysenagolli me 17

pikë e dhjetë kërcime, derisa te Sigal Prishtina më i miri ishte Tyrrel Tate me 18 pikë e katër kërcime, njëherësh ishte i huaji i vetëm që u paraqit te prishtinasit. Tirana ka dy fitore e dy humbje, ndërsa për Sigal Prishtinën ishte humbja e parë pas tri fitoreve.

Kosova në mars zhvillon dy ndeshje ndaj Ukrainës

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ka mbetur edhe një muaj deri te ndeshjet thujse vendimtare të Kombëtares së Kosovës në hendboll për kualifikim në Kampionatin Evropian të vitit të ardhshëm. Më 13 mars në Prishtinë, nga ora 20:15, është ndeshja mes Kosovës dhe Ukrainës. Menjëherë më 16 mars është ndeshja Ukrainë - Kosovë. Për shkak të pushtimit rus, Ukraina ndeshjet si nikoqire i luan në vende të tjera. Ndeshjen me

Kosovën ka vendosur ta organizojë në Klaipeda të Lituanisë. Kombëtarja e Kosovës dhe ajo e Ukrainës janë në Grupin 6 të kualifikimeve të Evropianit për hendbollistë. Tashmë janë luajtur dy xhiro. Më 6 nëntor Kosova luajti në Torshavn dhe pësoi humbje 32:21 nga Ishujt Faroe. Ukraina një ditë më pas humbi 40:39 nga Holanda. Menjëherë më 10 nëntor, Kombëtarja jonë i përmirësojë dukshëm përshtypjet, duke

barazuar 33:33 me Holandën në Prishtinë. Holanda është favorite e madhe e grupit. Ndërkohë Ukraina fitoi 35:32 ndaj Ishujve Faroe. Dy të parët në grup kualifikohen në Evropian, ndërsa gjasa për kualifikim ka edhe prej vendit të tretë. Kualifikohen gjysma e tetë kombëtareve që përfundojnë në vendin e tretë, por që nuk llogariten rezultatet e ndeshjeve me kombëtaren e vendit të katërt.



Ancelotti: Fitore e merituar, ishim efektivë në sulm

MADRID, 12 SHKURT - Real Madridi shënoi fitore me rezultat 3-2 ndaj Manchester Cityt në "Etihad Stadium". Pas ndeshjes Carlo Ancelotti është shprehur i kënaqur me fitoren e arritur dhe epërsinë e vogël për ndeshjen e kthimit. "Jam i qetë dhe i

lumtur, pa dyshim. Ne dalim mirë në ndeshjen e parë të raundit eliminator, kaluam një epërsi të vogël dhe duhet të shkojmë në ndeshjen e kthimit me besim. Ndeshja shkoi mirë, ishte një lojë e kompletuar në të gjitha aspektet. Ne u mbrojtëm

mirë, të gjithë punuan, ishim efektivë përpara, patëm shumë mundësi shënimi", ka thënë Ancelotti, i cili ka shtuar se klubi që ai e drejton arriti fitore të merituar. "Fitorja është e merituar. Ne ishim shumë të rrezikshëm në sulm, katërshtja e

përparme ishte shumë efektive. Mund të ishim më të saktë, por krijuan shanset me lëvizshmërinë dhe cilësinë e tyre. Unë nuk kritikoj asgjë në këtë ndeshje dhe nuk vendos asnjë, por për të gjetur gjëra të tjera", ka shtuar Ancelotti.



Guardiola: Humbasim shumë ndeshje në fund

MANCHESTER, 12 SHKURT - Humbja 2-3 përballë Realit të Madridit me "Etihad"-in e ka bërë edhe më të vështirë kualifikimin e Manchester Cityt mes 16 më të mirave në Ligën e Kampionëve. Pep Guardiola e pranoi se paaftësia e skuadrës së tij par të mbajtur avantazhin këtë sezon është diçka e vështirë për t'u kontrolluar: "Sot ishte një ndeshje e ngushtë dhe në disa çaste patëm raste. Humbasim shumë ndeshje në fund. Në këtë nivel është shumë e vështirë. Nuk është hera e parë, ndodh shpesh. Ka gabime në zona të ngjashme. Është e vështirë për t'u menaxhuar, por po ndodh shumë herë. Lojtarët marrin vendime në moment, ndonjëherë funksionon dhe ndonjëherë jo. Arritëm në minutën e fundit me rezultat pozitiv, por nuk mundëm ta ruanim atë. Kjo është



përgjegjësi e të gjithëve, jo vetëm e lojtarëve. Nuk kam problem ta pranoj që nuk po funksionon si më parë. Është çështje e të gjithëve". Në vijim, Guardiola shpjegoi se, pavarësisht dëshirës, skuadra e tij nuk është e qëndrueshme në çaste të caktuara. "Ata e duan fitoren, shihni si vrapojnë dhe si luajnë, por e vërteta është se nuk jemi mjaftueshëm të

qëndrueshëm në momentet vendimtare. Në fund sot ishte siç ishte dhe nga nesër duhet të vazhdojmë të mësojmë. Bëmë shumë gjëra të mira në lojë. Rezultati është ky që është. Sigurisht, kemi bërë gjëra pozitive, por ka edhe vend për përmirësim. Gjithmonë duhet të japim merita kundërshtarit dhe cilësisë që ka", ka shtuar Guardiola. "Ka ndodhur shumë herë këtë sezon. E di cilësinë e Real Madridit. Në pjesën e dytë morëm iniciativën, por u përpoqëm të sulmonim shumë shpejt. Kjo ndodh sepse ata janë një ekip i jashtëzakonshëm. Kjo ka ndodhur shumë herë këtë sezon. Vendime të këqija, kaq. E marr përsipër. Nuk është çështje e një personi apo tjetrit, por e të gjithëve. Po, lëndimet na kanë ndjekur gjithë sezonin, por e dimë këtë", ka deklaruar Guardiola.

Duranti shkruan historinë e NBA-s, fitojnë Memphisi, Toronto dhe Detroiti



PHILADELPHIA, 12 SHKURT - Basketbollisti Kevin Durant bëhet lojtari i tetë në historinë e NBA-së që arrin kuotën e 30 mijë pikëve të realizuara në sezonin e rregullt. Ai realizoi 34 pikë për skuadrën e Phoenixit edhe pse ato nuk mjaftuan për

të fituar. Memphisi triumfoi me rezultat 119-112 ndaj Phoenixit, në një ndeshje ku lojtarët e stolit të skuadrës mike realizuan 44 pikë (Desmond Bane me 20 pikë shënuesi më i mirë për miqtë). Jashtë fushës fitoi edhe Toronto, që mundi me rezultat 106-103

REZULTATET	
Philadelphia - Toronto	103-106
Indiana - New York	115-128
Chicago - Detroit	92-132
Phoenix - Memphis	112-119

Philadelphian, ndeshje me rivalitet deri në fund. Barnesi me 33 pikë u dallua për kanadezët, duke i bërë të pavlefshme 27 pikët e Embiidit për vendasit. Triumfoi skuadra e Detroitit, që falë 24 pikëve të Beasleyt, mundi thellë me rezultat 132-92 Chicagon. Fitoi edhe New Yorku, që mundi me shifrat 128-115 Indianan jashtë fushës. Townsi me 40 pikë dhe Harti me 30 u dalluan për njujorkezët.

SHKURT

Drejtori i Evertonit: Broja rikthehet më shpejt sesa pritej

Dritë në fund të tunelit për Armando Brojën. Sulmuesi shqiptar është jashtë prej disa javësh, por duket se rikuperimi nga dëmtimi po shkon shumë mirë. Drejtori sportiv i Evertonit, Kevin Thelwell, ka zbuluar se Broja do të rikthehet nga dëmtimi më herët sesa ishte parashikuar. "Broja do të rikthehet më herët sesa pritej. Na janë dëmtuar tre sulmues shumë të mirë. Edhe Çermiti u rikthye më herët nga sa pritej. Beto bëri gjërat në mënyrë të shkëlqyer në javën e kaluar duke shënuar gola, të shohim nëse mund të shënojë ndonjë tjetër. Sulmuesit që do të rikthehen nga dëmtimet mund të dëshmojnë se janë të aftë të na ndihmojnë në fitimin e ndeshjeve", ka thënë Thelwell. Broja është i huazuar tek Evertoni nga Chelsea dhe synon t'i bindë drejtuesit për ta blerë kartonin e tij në verë. Mbetet të shihet nëse sulmuesi do të rikuperohet në kohë për të qenë i gatshëm për ndeshjet kualifikuese të Shqipërisë në muajin mars.

Vinicius: Dëshira ime është të qëndroj në Real

Braziliani Vinicius Jr padyshim është ndër yjet kryesor të Real Madridit. Ai bëri asistimin që i dha Real Madridit fitoren 2-3 ndaj Manchester Cityt në "Etihad". Ditë më parë kishte zëra për largimin e tij me skuadrat nga Arabia Saudite që iu vunë pas brazilianit. Mirëpo është vetë Viniciusi ai që konfirmoi se dëshiron të qëndrojë dhe ta nënshkruajë kontratën e re me Realin. "Po flasim për kontratë të re. Dëshira ime është të qëndroj këtu për një kohë të gjatë, të bëj histori për Real Madridin". "Dëshiroj të qëndroj gjithmonë e më gjatë! Shpresoj që në ditët në vijim të zgjidhim gjithçka për të qëndruar për një kohë të gjatë", u shpreh Viniciusi. Braziliani këtë sezon ka bërë 30 paraqitje ku ka shënuar 16 gola dhe ka bërë 11 asistime për "Galaktikët".

Haalandi kalon Shevchenkon dhe Ibrahimoviqin në renditjen e golashënuesve në LK

Sulmuesi i Manchester Cityt, Erling Haaland, ka vazhduar të shkruajë histori, duke bërë edhe një arritje të madhe në Ligën e Kampionëve. Real Madridi siguroi një fitore dramatike me rezultat 3-2 ndaj Manchester Cityt në ndeshjen e parë të "play-off"-it për një vend në fazën e 1/8-tës në garën elitare evropiane të klubeve. Pavarësisht prej humbjes, ylli i Cityt, Erling Haaland, i ka shënuar të dy golat për skuadrën e tij. Me dy golat e tij, norvegjezi 24-vjeçar ka kaluar tani legjenda si Andriy Shevchenko dhe Zlatan Ibrahimoviq në renditjen e të gjitha kohëve të golashënuesve në Ligën e Kampionëve, duke vendosur veten në vendin e 10. Haalandi ka shënuar 49 gola në vetëm 48 ndeshje, një rekord mahnitës. Në krahasim, Shevchenko shënoi 48 gola në 100 ndeshje, ndërsa Ibrahimoviqi arriti të njëjtin numër në 124 ndeshje. Deri më tani këtë sezon, Haalandi ka regjistruar 27 gola dhe 2 asistime në 33 paraqitje në klubin nga "Etihad".

Del në ankand makina me të cilën Schumacheri debutoi në Formula 1

Vazhdon pa ndërprerje nxjerrja në ankand e disa prej makinave që kanë bërë historinë e Formulës 1 dhe garës së famshme 24-orëshe në Le Mans, të gjitha të shitura nga kompania "RM Sotheby". Pas shifrës rekord të arritur me blerjen e Mercedesit të vitit 1954, ditët në

vijim koleksionistët do të mund t'i bëjnë ofertat e tyre për Benetton B191. Bëhet fjalë për njëvendëshen me të cilën Michael Schumacher konkurroi në sezonin e tij të parë në Formula 1 në skuadrën britanike më 1991. Schumacher arriti rezultate premtuese në Monza,

Portugali dhe Spanjë në debutimin e tij në F1, në mes të sezonit, përpara se të fillonte vitin e tij të parë të plotë në F1 një vit më vonë (1992). Asokohe ai garoi me një Benetton-Ford 191, me të cilën u ngjiti edhe tri herë në podium. Pasi u tërhoq nga garat, makina iu shit një

pronari privat përpara se të blihej nga Muzeu Indianapolis Motor Speedway në 2005, ku qëndron edhe sot. Sot shasia B191-08 ofrohet me një ngjyrë shumë të ngjashme me atë të Benetton të vitit 1993 si për sa i përket estetikës së makinës me një vend ashtu edhe për

elementë të tjerë si pasqyrat e pasme. Një makinë me kutinë e shpejtësisë dhe motorin ende original, por edhe me certifikatën e originalitetit të Benetton që konfirmon përdorimin e makinës nga Schumacheri. Ofertat e para do të pranohen nga data 27 shkurt.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

